



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr 34, datë 10.03.2022

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. **Z. Dritan Gripshi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
2. Z. Dritan Gripshi, do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, nga data 30.03.2022 - 29.06.2022.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Z. Gripshi do të paguhet me pagën e pozicionit të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
4. Të njoftohen për këtë vendim Z. Dritan Gripshi, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më datë 10.03.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZËVENDËSKRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
SOKOL STOJANI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
ZEQIR HODA

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

ANËTAR  
LUDOVIK DODAJ

ANËTAR  
MIRELA BOGDANI